

Berat Reçani, MA¹

UDC: 342.24(73)

FUNKSIONIMI I SISTEMIT FEDERATIV NË SHBA**ФУНКЦИОНИРАЊЕ НА ФЕДЕРАЛНИОТ СИСТЕМ ВО САД****THE FUNCTIONING OF THE FEDERAL SYSTEM IN THE USA****Abstract**

The end of the so-called Cold War marked the beginning of globalist processes and the construction of a new world order, where the United States of America plays a leading role, which, with its policy, is dictating the course of this process.

Founded as a weak confederal union of thirteen states, America today represents a military, economic, and political superpower, a democratic state based on federal unity and complete ethnic, cultural, and linguistic diversity where citizens of different ethnic, linguistic, and religious backgrounds coexist, with the aim of creating a contemporary civilization and general well-being.

The American system represents the main model of a stable and sustainable modern democracy. Established by the Constitution of 1787, the American system of government has survived political changes over the centuries, has developed in parallel with time and currently operates as a functional democracy, based on the separation and mutual control of powers, the presidential system, federalism, civil liberties and rights, and a range of other democratic and political values that ensure the stability of American democracy.

Hyrje

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë në fuqi juridike kushtetutën më të vjetër në kuptimin formal si një akt themelor juridiko i shkruar dhe i kodifikuar, e bazuar në parimet e Deklaratës së Pavarësisë (1776), e cila thekson barazinë e së drejtës, ekzistencën e të drejtave që nuk preken, nga shteti dhe pushtetin e dalë nga populli. Këto përbëjnë, në fakt, parimet ndërtuese të

¹ Mr. Sc. Berat Reçani, Faculty of Law, South East European University.

demokracisë bashkëkohore. Sistemi presidencial në SHBA përfshin tre degë qeverisëse të pushtetit shtetëror: degën ekzekutive, degën legjislative dhe degën gjyqësore. Në sistemin politik amerikan, presidenti është njeriu i parë në krye të fuqisë më të madhe botërore. I zgjedhur de facto nga populli, ai formon lirisht qeverinë e tij (kabinetin presidencial), e cila nuk mund të përmbysset nga parlamenti. I pajisur me pushtet dhe mjete kushtetuese-politike, ai drejton vendin. Etërit themelues të kushtetutës amerikane sollën në konventën kushtetuese bindjen e tyre se grumbullimi dhe koncentrimi i të gjitha pushteteve - legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në të njëjtat duar me të drejtë mund të identifikohet me tiraninë.

Rëndësia e punimit hulumtues shkencor

Sistemi presidencial në formën e tij burimore është krijuar dhe ekziston në SHBA. Bartësi i pushtetit legjislativ në SHBA është Kongresi, i përbërë nga dy dhoma: Dhoma e përfaqësuesve dhe Senati. Dhoma e përfaqësuesve përbëhet nga deputetë të zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët me mandat prej 2 vjet, ndërsa Senati përbëhet nga 100 senatorë (2 nga çdo shtet federal) të zgjedhur me mandat prej 6 vjet. Pushteti ekzekutiv në SHBA është monocefal, që do të thotë të gjitha funksionet e tij janë besuar një organi - Presidentit të SHBA-së (nuk ekziston qeveria). Por, fakti që në SHBA ekziston pushteti ekzekutiv monocefal nuk duhet të na çojë në përfundimin se presidenti vetë i kryen të gjitha punët që janë në kompetencë të pushtetit ekzekutiv. Në kryerjen e punëve, presidentit i ndihmon kabineti që paraqet një trup joformal i cili në SHBA përbëhet nga eprorët (sekretarët shtetërorë) dhe dymbëdhjetë departamenteve (resorëve administrativë). Anëtarët e kabinetit presidencial i emëron presidenti, pas pëlqimit paraprak nga Senati, por ata përgjigjen vetëm para presidentit. Kabineti nuk vendos në formë kolegjiale (kolektive) dhe në seancat e tij nuk votohet, vetëm nëse këtë nuk e kërkon presidenti, por ai vendimet i merr pavarësisht nga rezultati i votimeve. Nga anëtarët e kabinetit pritet që ata t'i pranojnë vendimet e presidentit pa bërë publike mospajtimet e tyre. Megjithatë, ekzistimi i kabinetit nuk mund ta rrezikojë presidentin në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv dhe nuk mund ta deformoj konceptin e pushtetit ekzekutiv monocefal. Kabineti presidencial nuk paraqet qeveri, përkatësisht kabineti qeveritar në kuptimin klasik të fjalës, por më shumë i ngjanë një grupi ministrash që janë përreth shefit të pushtetit ekzekutiv dhe që zbatojnë urdhrat e tij. Sekretarët shtetërorë janë këshilltarë, e jo bashkëpunëtorë të presidentit. Presidenti, megjithatë, është bartësi dominues i pushtetit ekzekutiv, i cili zgjidhet pavarësisht nga trupi ligjvënës, në rrugë të procedurës komplekse (të ndërlikuar). Në çdo njësi federale në SHBA drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe në bazë të listës së partive politike, zgjidhen aq elektorë sa që nga ajo zgjidhen përfaqësues dhe senatorë në kongres. Këta elektorë pastaj votojnë për presidentin dhe nënpresidentin. Për këtë arsye flitet për

“legjitimitet të dyfishtë demokratik“ në sistemin presidencial - edhe presidenti që kontrollon pushtetin ekzekutiv, edhe trupi legjislativ janë të zgjedhur nga qytetarët, ata kanë bazë demokratike të njëjtë të legjitimitetit. Nga ana tjetër, edhe presidenti edhe trupi legjislativ janë të zgjedhur me mandat të caktuar dhe nuk mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e mandatit të organit tjetër, pra trupi legjislativ nuk mund “të votojë për mosbesim“ të presidentit, por edhe presidenti nuk mund ta shpërndajë parlamentin. Sistemi presidencial, përveç me parimin e ndarjes së rreptë, karakterizohet edhe me ekzistencën e sistemit të kontrollit dhe baraspeshës ndërmjet pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, me qëllim që të mbahet baraspesha funksionale institucionale ndërmjet tyre.

1. Vështrim historik i zhvillimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Bazuar në dokumentet historike të kohës, mijëra vjet para ardhjes së evropianëve, kontinenti i Amerikës Veriore ka qenë i popullarizuar me popullsi aziatike që kishte shkuar atje nga Siberia. Kultura e tyre u zhvillua dhe u përhap anembanë kontinentit dhe ata ishin atje për t'i pritur evropianët e parë, të cilët e zbuluan kontinentin e ri gjatë përpjekjeve të tyre për të gjetur një rrugë më të shkurtër ujore për në Azi. Marinari Italian, Kristofer Kolombo (1451-1512), i cili gjendej në shërbim të mbretit Ferdinand dhe mbretëreshës Isabella të Spanjës, mendohet të ketë qenë evropiani i parë që e zbuloi Amerikën. Ai kishte bërë katër lundrime për në Ishujt e Karibeve dhe Amerikën Jugore, ndërsa në vitin 1492, duke menduar së kishte mbërritur në brigjet e Indisë, Kolombo, kishte shkelur në ujdhesat e Kubës dhe Hispanjolës. Por Bota e Re, të cilën e kishte zbuluar Kolombo, nuk u emërua sipas emrit të tij, por sipas një peshkatari që quhej Ameriko Vespuçi (1454-1512). Në vitin 1508, dy vjet pas vdekjes së Kolombos, gjeografi Martin Voldsimiler, i cili ishte një admirues i Vespuçit, pohonte se Ameriko ishte ai i cili e zbuloi këtë pjesë të botës, prandaj vendi duhet të quhej Amerika.²

Emigrimet e para

Gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe viteve të para të shekullit të tetëmbëdhjetë mijëra emigrantë nga Evropa, kryesisht nga Britania e Madhe, emigruan për në Amerikë. Arsytet e shpërnguljes së tyre ishin të lidhura me keqtrajtimet politike e religjioze, si dhe me dëshirën e emigrantëve për një jetë më të mirë.

Separatistët dhe marrëveshja “Mayflower”: Emigrantët e parë të cilët u detyruan të linin vendin e tyre për arsye të ndryshme, ishin të vetëdijshëm për rolin e rëndësishëm të qeverisë në jetën e tyre. Për këtë arsye ato

² Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 11.

ende pa arritur në Amerikë u dakorduan për hartimin e një dokumenti mbi bazën e të cilit do të nxirrnin dhe do të implementonin ligjet për udhëheqjen e komunitetit të ri. Shumica e atyre që e votuan marrëveshjen “Mayflower”, edhe pse e dinin se ende do të ishin nën juridiksionin e Mbretërisë së Bashkuar, dëshironin që t’i mbronin të gjithë të drejtat e meshkujve që kishin ardhur në Amerikë. Kjo marrëveshje, që është dokumenti i parë i qeverisjes në Amerikë, nuk ishte kushtetutë, por një deklaratë politike, me të cilën shprehej dëshira dhe vendosmëria e emigrantëve për të jetuar mbi bazën e shtetit ligjor.³

1.1 Historiku i zhvillimit juridiko-politik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Rruga e krijimit të SHBA-ve krahasimisht më shumë vende të botës ka dimensione specifike, në bazë të të cilave ajo më shumë çka dallohet prej tyre. Përderisa shumica e vendeve evropiane dhe botërore kishin kaluar një rrugë të gjatë të zhvillimit, duke përjetuar edhe faza të mëhershme të zhvillimit të tyre, mbi bazë të të cilave kishin arritur t’i përsosnin mekanizmat e tyre shtetëroro-juridikë, SHBA-të do të formohen si shtet më vete, pa i përjetuar si subjekt i pavarur ato periudha. SHBA-të specifikën tjetër thelbësore të tyre e shprehin edhe sipas faktit se si shtet më vete do të formohen me anë të shkëputjes nga fuqitë koloniale të kohës, me anë të një procesi të gjatë e të vështirë, ato po ashtu do të formohen nga një substrat heterogjen i popullsisë, e cila kishte ardhur në kontinentin e ri nga shumë vende të Evropës. Ky substrat kaq heterogjen e i përbërë prej njerëzve të gjuhëve, të kulturave dhe të bindjeve të ndryshme religjioze, të cilat me kohë do ta arrijnë idealin e tyre të përbashkët për jetë të pacenueshme, liri, fat dhe lumturi. Shteti Amerikan, për dallim prej shumicës së vendeve të kohës, do të krijohet si rregullim shtetëror diferent. Shkëputja nga statusi i kolonive dhe nga kurora mbretërore britanike do të shprehet simbolikisht, por edhe realisht, si shkëputje e menjëhershme nga regjimet e traditës monarkiste, të cilat i përjetoi shekuj me radhë Anglia. Shteti Amerikan si republikë demokratike me tri pushtetet e ndara nëpërmes kushtetutës, do të krijohet dhe përsoset si model po ashtu tepër specifik më vete, prandaj duke pasur parasysh konstatimet e lartëshënuara dhe rrethanat e përgjithshme në të cilat u formuan SHBA-të, e kaluara e tyre e paraformimit mund të cilësohet si histori e migrimeve, histori e kolonizimit dhe histori e diversiteteve.⁴

Zhvillimi shtetëror juridik i SHBA-ve përputhet pothuajse tërësisht me periodizimin e përgjithshëm që i bëhet kësaj faze të zhvillimit të shoqërisë

³ Po aty, f. 12.

⁴ Hilmi Ismaili, Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë 2009, f. 311-312.

njerëzore, pra, formacionit shoqëroro-ekonomik kapitalist. Kështu, SHBA-të do ta fillojnë pavarësinë e tyre në fund të shekullit XVIII, në kohën kur do të bëhet edhe përmbyjsja e sistemit feudal, për ta filluar këtu edhe rrugëtimin e tyre shtetëror që në startin e fazës së parë. Andaj, mund të thuhet se SHBA-të deri tash do të kapërcejnë tri faza të rëndësishme të zhvillimit të tyre dhe që mund të përmbliken kryesisht me këtë ndarje kohore: faza e parë, do të fillojë në fund të shekullit XVIII, më saktë nga viti 1776, si vit i pavarësisë amerikane, dhe do të zgjasë deri në luftën secesioniste civile amerikane, më saktësisht fundin e saj deri në vitin 1866, e që me karakteristikat që përmban në vete përputhet tërësisht me të gjitha elementet e liberalizimit. Faza e dytë fillon nga fundi i luftës secesioniste amerikane dhe vazhdon deri në fundin e Luftës së Parë Botërore. Këtë fazë e karakterizon konsolidimi i përgjithshëm i brendshëm i SHBA-ve rritja e fuqisë së saj ekonomike dhe politike dhe për dekadat e para konservimi i saj të brendshëm “brenda kontinentin”, sipas doktrinës Monros, që moto kryesore kishte sintagmën “Amerika e amerikanëve”. Faza e tretë, që do të zgjasë sot e kësaj dite, me nënfazat e veta të zhvillimit nga fundi i Luftës së Parë Botërore dhe nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e deri sot përshkohet me zhvillimin kulminant të SHBA-ve si fuqi politike ekonomike e ushtarake botërore.⁵ Pas zbulimeve të mëdha gjeografike, udhëtimin të Kolombos dhe zbulimit të kontinentit të ri më 1492, fuqitë evropiane filluan garën e tyre për të nxënë pozicione në tokën e re. Në shekullin XVI dhe në fillim të shekullit XVII, Anglia, Franca, Spanja, Portugalia dhe Holanda do të fillojnë t’i formojnë kolonitë e para e tyre të para në territorin e tërë kontinentit. Popullsia e shpërngulur nga vendet e Evropës do të vendoset në pjesët më të përshtatshme të bregdetit lindor në Atlantik, duke krijuar qendra të rëndësishme të përqendrimit të tyre, veçanërisht në portet detare, si Bostoni, Nju Amsterdami (Nju Jorku i sotëm) dhe qendrat e tjera të cilat tashmë kishin filluar të merrnin fizionominë e porteve të vërteta.

Nga viti 1607, kur u formua kolonia e parë Jamestown, në emër të James I (Virgjinia e sotme), e deri në vitin 1733, në territorin e Amerikës Veriore u formuan 13 koloni. Për nga vendshtirja e kolonive ato mund të ndahen në tri grupe themelore: 1) Kolonitë e Anglisë së re (New England), 2) Kolonitë e mesme dhe 3) Kolonitë jugore.

Për nga mënyra e formimit të kolonive angleze në Amerikë, po ashtu dallohen tri mënyra: 1) Kolonitë Proniare (*proprietary*), 2) Kolonitë me privilegje (*selfgoverning*) dhe 3) Kolonitë mbretërore (*Royal*)⁶

⁵ Po aty.

⁶ Hilmi Ismaili, Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë 2009, f. 312-313.

2. Kushtetuta Amerikane si burim i demokracisë bashkëkohore dhe sfidat e saj

Kushtetuta Amerikane sa i përket kompetencës së organit që e ka nxjerrë, dhe që e ka të drejtën ta ndryshojë, i ka besuar Kuvendit Kushtetutëdhënës, si organ i thirrur për të nxjerrë kushtetutën, i cili organ përfaqëson njësitë federale të federatës amerikane. e para, procedura për nxjerrjen e kushtetutës, ka shkuar, nëpërmjet Kuvendit Kushtetues, dhe pastaj ka marrë ratifikimin nga shtetet anëtare, pra një procedurë shumë e vështirë; e dyta, miratimi i kushtetutës është dashur të merr shumicë të kualifikuar të votave nga shtetet, gjegjësisht të merr së pari shumicën në Kuvendin Kushtetues, dhe pastaj të ratifikohet nga njësitë federale; e treta, ngase ndryshimi i saj përveç hapave që i përmendëm më lartë kërkon edhe ratifikimin e ndryshimit nga $\frac{3}{4}$ e njërive federale. Pra shihet se Kushtetuta amerikane për nga cilësitë që i jep forma e saj, merr atributin e një kushtetute shumë të qëndrueshme, siç është i qëndrueshëm dhe stabil edhe i tërë sistemi qeverisës i këtij vendi.⁷ Kur themi se Kushtetuta është akti më i lartë juridik i SHBA-ve, atëherë nënkuptojmë se kushtetuta amerikane, ka vendin e parë në hierarkinë e akteve juridike në Shtetet e Bashkuara. Kushtetuta amerikane, pikërisht për shkak të fuqisë së saj juridike, që përcaktohet nga forma e saj, mban vendin e parë në hierarkinë e akteve juridike. Andaj, fuqia e kushtetutës amerikane, është “më e madhja” ndër tërë aktet tjera juridike, si e tillë, kushtetuta është burim për tërë aktet tjera juridike. Nëse trajtojmë, pozitën e SHBA-ve, nga këndi i rregullimit të brendshëm shtetëror, atëherë, do të shohim se SHBA-të janë shtet federativ, çështje që do të trajtohet bashkë me kushtetutën ngushtësisht. “Harmonia” e akteve më të ulëta juridike me kushtetutën si akti më i lartë, shprehet në radhë të parë në përputhshmërinë e akteve më të ulëta me ato më të larta, dhe në radhë të dytë në mos kundërshtinë e akteve më të ulëta juridike me kushtetutën amerikane, ka të bëjë me burimin e të gjitha autorizimeve vetëm prej kushtetutës. Ndërsa “moskundërshtimi” ka të bëjë pikërisht me mos ekzistencën e kundërshtimit në mes obligimit ose ndalesës që e jep kushtetuta dhe pamundësisë së akteve juridike më të ulëta se kushtetuta, që të jenë në kundërshtim me të. Pra, sistemi juridik i një vendi, e në rastin tonë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duhet të jetë harmonik, e që shprehet në mos kundërshtinë dhe përputhshmërinë e normave juridike brenda sistemit juridik amerikan. Është më rëndësi të trajtohet kushtetuta edhe në raport me pasojat juridike që i nxjerr. E para kushtetuta amerikane është akt që “autorizon pushtetin” apo prej të cilit buron pushteti, dhe e dyta akt që “kufizon pushtetin”. Pra si akt i tillë, e vë

⁷ Fisnik Korenica, Dren Doli, Kushtetuta Amerikane dhe rruga juridike deri te ajo, Prishtinë 2005, f. 102-104.

veten në pozitë mbi pushtetin shtetëror, dhe në këtë mënyrë, ai shndërrohet në akt juridik të cilit i nënshtrohet pushteti.⁸

York Kongresi i sapo zgjedhur, ai i miratoi dhjetë amendamentet e Kushtetutës të njohura së bashku si Karta e të Drejtave-Bill of Rights. Karta e të Drejtave përshkruhej nga synimi për “vendosjen e drejtësisë”. Ajo si e gjithë Kushtetuta nuk bënte dallime për sa i përket pasurisë apo statusit individual: të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe të gjithë ishin subjekt i gjyqimit dhe ndëshkimit kur shkelnin ligjin. Rrugët e lira për t’iu drejtuar gjykatës përbënin një nga garancitë jetike të shkruara në Kartën e të Drejtave.⁹

3. Shtetet Federale të Amerikës

Në Shtetet e Bashkuara, një shtet është një njësi politike përbërëse, nga të cilat aktualisht janë 50. Të lidhur së bashku në një bashkim politik, çdo shtet ka juridiksion qeveritar mbi një territor gjeografik të veçantë dhe të përcaktuar ku ndan sovranitetin e tij me qeverinë federale. Për shkak të këtij sovraniteti të përbashkët, amerikanët janë qytetarë si të republikës federale ashtu edhe të shtetit në të cilin ata banojnë. Shtetësia dhe vendbanimi shtetëror janë fleksibël dhe nuk kërkohet miratim nga qeveria për të lëvizur ndërmjet shteteve, me përjashtim të personave të kufizuar nga disa lloje të urdhrave të gjykatës (si të dënuarit e liruar me kusht dhe fëmijët e bashkëshortëve të divorcuar që ndajnë kujdestarinë).

Qeverive të shteteve në SHBA u ndahet pushteti nga njerëzit (të secilit shtet përkatës) përmes kushtetutave të tyre individuale të shtetit. Të gjitha bazohen në parimet republikane (kjo kërkohet nga kushtetuta federale), dhe secila parashikon një qeveri, të përbërë nga tre degë, secila me pushtete të veçanta dhe të pavarura: ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Shtetet ndahen në qarqe ose qarqe-ekuivalente, të cilave mund t’u caktohet ndonjë autoritet i qeverisjes vendore, por nuk janë sovrane. Struktura e qarkut ose ekuivalentit të qarkut ndryshon gjerësisht sipas shtetit, dhe shtetet krijojnë gjithashtu qeveri të tjera lokale. Shtetet, ndryshe nga territoret e SHBA-së, zotërojnë shumë kompetenca dhe të drejta sipas Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Shtetet dhe qytetarët e tyre përfaqësohen në Kongresin e Shteteve të Bashkuara, një legjislaturë dydhomëshe e përbërë nga Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve. Çdo shtet ka gjithashtu të drejtë të zgjedhë një numër zgjedhësish (të barabartë me numrin total të përfaqësuesve dhe senatorëve nga ai shtet) për të votuar në Kolegjin Zgjedhor, organi që zgjedh drejtpërdrejt presidentin e Shteteve të Bashkuara. Për më tepër, çdo shtet ka mundësinë të ratifikojë amendamentet

⁸ Fisnik Korenica, Dren Doli, Kushtetuta Amerikane dhe rruga juridike deri te ajo, Prishtinë 2005, f. 105.

⁹ Llambr Filo, Juliana Marko, Historisë e Kohëve Moderne, Tiranë 2006, f. 74.

kushtetuese dhe, me pëlqimin e Kongresit, dy ose më shumë shtete mund të hyjnë në marrëveshje ndërshtetërore me njëri-tjetrin. Fuqia policore e çdo shteti njihet gjithashtu. Historikisht, detyrat e zbatimit të ligjit vendor, edukimit publik, shëndetit publik, rregullimit të tregtisë ndërshtetërore dhe transportit dhe infrastrukturës lokale, përveç zgjedhjeve lokale, shtetërore dhe federale, përgjithësisht janë konsideruar kryesisht si përgjegjësi shtetërore, megjithëse të gjitha këto tani kanë financime dhe rregullore të rëndësishme federale gjithashtu. Me kalimin e kohës, Kushtetuta është ndryshuar, interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të saj ka ndryshuar. Tendenca e përgjithshme ka qenë drejt centralizimit dhe inkorporimit, me qeverinë federale që luan një rol shumë më të madh se dikur. Ka një debat të vazhdueshëm mbi të drejtat e shteteve, i cili ka të bëjë me shtrirjen dhe natyrën e pushteteve dhe sovranitetit të shteteve në lidhje me qeverinë federale dhe të drejtat e individëve.

Kushtetuta i jep Kongresit autoritetin për të pranuar shtete të reja në Bashkim. Që nga themelimi i Shteteve të Bashkuara në vitin 1776 nga Trembëdhjetë Kolonitë, numri i shteteve është zgjeruar nga 13 fillestare në 50. Çdo shtet i ri është pranuar në baza të barabarta me shtetet ekzistuese. Ndërsa Kushtetuta nuk diskuton në mënyrë eksplicite çështjen nëse shtetet kanë fuqinë për t'u shkëputur nga Bashkimi, menjëherë pas Luftës Civile, Gjykata e Lartë e SHBA-së, në *Texas v. White*, vendosi se një shtet nuk mund ta bëjë këtë në mënyrë të njëanshme. 13 shtetet origjinale u krijuan në korrik 1776 gjatë Luftës Revolucionare Amerikane (1775-1783), si pasardhës të Trembëdhjetë Kolonive, pasi ranë dakord me Rezolutën e re dhe nënshkrimin e Deklaratës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara. Para këtyre ngjarjeve çdo shtet kishte qenë një koloni britanike; secili u bashkua më pas në Bashkimin e parë të shteteve midis viteve 1777 dhe 1781, pas ratifikimit të Neneve të Konfederatës, kushtetutës së parë të SHBA-së. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, shtetet e reja të pavarura zhvilluan kushtetutat e tyre individuale shtetërore, ndër kushtetutat më të hershme të shkruara në botë. Megjithëse të ndryshme në detaje, këto kushtetuta shtetërore ndanin tipare që do të ishin të rëndësishme në rendin kushtetues amerikan: ato ishin republikane në formë dhe e ndanin pushtetin midis tre degëve, shumica kishin legjislatura dydhomëshe dhe përmbanin deklarata ose një projektligj. Më vonë, nga 1787 deri në 1790, secili prej shteteve ratifikoi gjithashtu një kornizë të re federale të qeverisjes në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara. Në lidhje me shtetet, Kushtetuta e SHBA përpunoi konceptet e federalizimit.¹⁰

¹⁰ Sq.m.wikipedia.org.

4. Organet Qendrore Shtetërore Federative të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe raporti reciprok mes tyre

Organet federative të Pushtetit janë Kongresi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Gjyqësori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

4.1 Pushteti ligjvënës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Kongresi i SHBA-së

Sipas kushtetutës së SHBA-së “i gjithë pushteti legjislativ ushtrohet nga Kongresi”. Është me rëndësi të theksohet se pjesa që i kushtohet pushtetit legjislativ në Nenin e parë të Kushtetutës, është më e gjatë se nenet tjera. Etërit Kushtetutës e konceptuan Kongresin si organ qendror i pushtetit kombëtar si më kompetent dhe si autoritet më i lartë. Në raportin e pushteteve dhe influencën e tyre midis tri degëve të pushtetit, legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit ata kanë synuar që të tri organet të ushtrojnë relativisht edhe sferën e kontrollit.

Megjithatë, Kongresi mbetet në sytë e shumicës si “pushteti përfaqësues shpëtimtar i shoqërisë”. Iniciativa legjislative në të shumtën e rasteve merrej, kryesisht, nga ana e presidentit. Por, në të njëjtën kohë ekziston edhe mundësia që ato propozime të tij të hedhen poshtë nga ana e Kongresit. Nëpërmjet kësaj të drejte përforcohet legjitimiteti i pushtetit ligjvënës në teorinë e sistemit përfaqësues.¹¹

4.2 Përbërja e Kongresit

Kongresi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është organ bikameral, i cili përbëhet nga Senati dhe Dhoma e përfaqësuesve. Përbërja e Senatit është caktuar me Kushtetutë dhe ata nga dy senator prej çdo shteti anëtar. Përbërja e Dhomës së përfaqësuesve është determinuar me aktin e Kongresit. Kongresi I Nëntëdhjetenëntë, i konvokuar me 3 janar 1985, përbëhej nga 511 burra dhe 24 femra (22 në Dhomën e Përfaqësuesve dhe 2 në Senat). Në përbërje të tij kishte 20 përfaqësues zezak, por asnjë në Senat. Mosha mesatare e senatorëve ishte 54,2 vjet ndërsa e Dhomës Përfaqësuese 49,7 vjet.¹²

Dhoma e Përfaqësuesve

Dhoma më e madhe e Kongresit është Dhoma e përfaqësuesve, anëtarët e të cilës zgjidhen drejtpërdrejt nga populli për një mandate dyvjeçar, me të drejtë të pakufizuar rizgjedhjeje. Sipas Kushtetutës federale, pavarësisht nga

¹¹ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 75.

¹² Po aty.

numri i popullsisë, secilit shtet i garantohet të paktën një përfaqësues në Dhomën e Përfaqësuesve.¹³ Përfaqësues nuk mund të jetë askush që nuk i ka mbushur 25 vjeç dhe që nuk ka qenë shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shtatë vjet, si dhe Kushtetuta parashikon që regjistrimet e përgjithshme kombëtare të bëhen çdo dhjetë vjet dhe, në përputhje me ndryshimet në numrin e popullsisë, të bëhet edhe rishpërndarja e vendeve në Dhomën e Përfaqësuesve. Legjislatura shtetërore përcaktojnë ndarjen e distrikteve në shtetet e tyre, në atë mënyrë që çdo përfaqësues të përfaqësojë numër të njëjtë të popullsisë. Kërkesa, sipas të cilës për çdo 30.000 banorë nuk duhet të ketë më shumë se një përfaqësues, e ka humbur kuptimin e saj, pasi sot ka një përfaqësues përreth 600.000 banorë. Me shtimin e shteteve dhe rritjen e numrit të popullsisë rritej edhe numri i anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve.

Në vitin 1929 Kongresi vendosi që numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të mbetet 435. Nëse në përfaqësimin e një shtetit mbetet ndonjë vend i zbrazët, për plotësimin e tij vendos dega e ekzekutive e atij shteti e cila urdhëron mbajtjen e zgjedhjeve për atë qëllim. Çdo dy vjet, pas mbarimit të zgjedhjeve, mblidhet Kongresi i ri, i cili nxjerr rregulloren e punës dhe bën zgjedhjen e zyrtarëve të vet. Zyrtari më i lartë në Dhomën e Përfaqësuesve është kryetar i saj - spikeri, i cili zgjidhet nga të gjithë anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve. Tradicionalisht ai vjen nga partia që ka numrin më të madh të ulëseve në Dhomën e Përfaqësuesve, ashtu siç vijnë edhe kryetarët e të gjitha komiteteve në të dy Dhomat e Kongresit. Spikeri i udhëheq dhe i mbikëqyrë seancat e Dhomës së Përfaqësuesve dhe është zëdhënës i saj. Ai, po ashtu, pas zëvendëspresidentit, është i dyti në radhë për ta zëvendësuar presidentin. Pas spikerit, zyrtarë më të rëndësishëm në Dhomën e përfaqësuesve janë: udhëheqësi i shumicës (majority leader) dhe udhëheqësi i pakicës (minority leader), të cilët në punët e tyre ndihmohen nga ndihmësit e tyre (vipat republikanë dhe demokratë).¹⁴

Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Senati është dhoma e dytë e Kongresit amerikan, e cila vendoset me kushtetutën e Shteteve të Bashkuara. Senati quhet dhoma e lart, përderisa Dhoma Përfaqësuesve është dhoma e ulët e Kongresit. Zakonisht “dhomë e ulët” quhet dhoma që e zgjedh populli, ndërsa “dhomë e lartë” quhet dhoma që zgjidhet nga një “subjekt tjetër”, në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fillim zgjidhej nga njësitë federale, ndërsa më vonë nga populli drejtpërdrejtë, por prapëseprapë ruajnë cilësinë e tyre si “përfaqësues të njësisë federale”.

¹³ Vështrim mbi Sistemin Amerikan të Qeverisjes, Zyra e programeve ndërkombëtare të informacionit, Departamenti i shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, f. 71.

¹⁴ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 59-61.

Senati i Shteteve të Bashkuara përbëhet nga dy senatorë për çdo shtet, të cilët fillimisht janë zgjedhur nga legjislaturat shtetërore, por që nga viti 1913, kur u adoptua Amandamenti i 17-të, zgjedhja e senatorëve bëhet nga populli i shteteve. Për dallim nga anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve, të cilët i nënshtrohen elektoratit për çdo dy vjet, senatorët zgjidhen me mandat gjashtëvjeçar, me të drejtë të pakufizuar të rizgjedhjes. Ata ndahen në tri grupe, në mënyrë që vetëm një e treta e senatorëve u nënshtrohen zgjedhjeve për çdo dy vjet. Sipas Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara nuk mund të jetë senator ai që nuk ka mbushur moshën tridhjetë vjeç, që nuk ka qenë së paku nëntë vjet banor i SHBA-ve dhe që nuk vazhdon të jetojë në shtetin nga i cili është zgjedhur. Edhe pse një shekull Senati funksionoi si një trup i barabartë, më vonë u vendos që edhe Dhoma e Lartë të zgjedhë lidërshpin e saj.

Dy zyrtarët më të lartë të Senatit mbajnë më tepër pozita simbolike. Sipas kushtetutës, zëvendës-presidenti i Shteteve të Bashkuara është president i Senatit dhe ai mund të votojë vetëm atëherë kur votat janë të barabarta. Meqenëse zëvendës-presidenti është i zënë me obligime të tjera dhe vetëm herë pas here merr pjesë në punët e Senatit, senatorët zgjedhin presidentin *pro tempore* për t'i kryesuar mbledhjet e Senatit. Tradicionalisht, në pozicionin e presidentit *pro tempore* zgjidhet senatori më i vjetër nga partia e shumicës. Lideri i vërtet i Senatit është udhëheqësi i shumicës, i cili, së bashku me udhëheqësin e pakicës përcakton orarin dhe rregullat e debatit. Të ndihmuar edhe nga ndihmësit e tyre liderët e Senatit përpiqen që të sigurojnë mbështetje për iniciativat legjislative të propozuara nga partitë e tyre, si dhe projektet e presidentit nëse ai vjen nga e njëjta parti. Në raste të impeachment, gjatë gjykimit të presidentit, Senatin e kryeson kryetari i Gjykatës Supreme dhe jo zëvendës-presidenti. Kjo mund të jetë bërë për faktin se dënimi i presidentit do të ngrite zëvendës-presidentin në postin e presidentit.⁶⁸ Kushtetuta nuk lejon që anëtarët e të dy dhomave të Kongresit të ushtrojnë edhe funksione tjera publike në SHBA.¹⁵

4.3 Sistemi i komiteteve

Sistemi i komiteteve është pjesë e organizimit të Kongresit. Është me rëndësi mandati i tyre si subjekte të mëvetësishme. Shumica e punëve në Kongres ushtrohet nëpërmjet komiteteve. Një nga veçoritë e Kongresit është roli zotërues i komiteteve në punimet e tij. Komitetet e kanë fituar rëndësinë që e kanë në ditët e sotme jo në bazë të përcaktimeve kushtetuese, por përmes një evolucioni gradual në praktikën e gjatë të tyre.

Sot Senati ka 17 komitete të rregullta (ose të përhershme) ndërsa Dhoma Përfaqësuese 19. Secili prej tyre është i specializuar për sfera specifike të legjislacionit: Në punët e jashtme, mbrojtje, banka, bujqësi, tregtia, caktim mesh fondesh e në fusha të tjera. Çdo projektligj i paraqitur në secilën dhomë

¹⁵ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 77.

i përcillet një komiteti, i cili duhet ta studioj e rekomandoj. Komiteti mund ta miratojë, rishikojë, hedhë poshtë ose injorë çdo veprim lidhur me të. Në Dhomën e Përfaqësuesve, peticioni që kërkon heqjen e një projekt ligji nga një komitet i caktuar për t'ia kaluar plenumit duhet të nënshkruhet nga 218 anëtarë, ndërsa në Senat nga shumica.¹⁶ Në secilën dhomë, procedurat e komiteve i ka nën kontroll partia shumicë (mazhoranca). Kryetarët e komiteve zgjidhen ose nga një forum anëtarësh partie, ose nga grupe anëtarësh të caktuar posaçërisht. Në komitete, partitë e vogla përfaqësohen proporcionalisht, në përputhje me forcën e tyre në secilën dhomë. Ka shumë mënyra për hartimin dhe prezantimin e projektligjeve. Disa përpilohen nga komitetet e përhershme, disa nga komitetet e posaçme, të krijuara enkas për të trajtuar tema legjislative të posaçme, kurse disa mund të sugjerohen nga presidenti. Kur një komitet përkrah një projektligj, ai i përcillet mbledhjes plenare për debat të hapur. Në Senat rregullat lejojnë debat thuajse të pakufizuar. Në Dhomën Përfaqësuese, për shkak të numrit të madh të anëtarëve, Komiteti i Rregullave zakonisht cakton disa kufizime. Kur debati merr fund, anëtarët votojnë ose për miratimin, ose për hedhjen poshtë apo shtyrjen e projektligjit ose për t'ia rikthyer komitetit.¹⁷

Impeachmenti

Konventa Kushtetuese, me rastin e miratimit të Kushtetutës, përcaktoi se askush nuk do të jetë mbi ligjin dhe se çdo president dhe funksionar tjetër i lartë mund të jetë objekt i impeachmentit. Të gjithë zyrtarët civil të qeverisë mund të shkarkohen dhe dënohen për “tradhti, mito dhe për krime të tjera të rënda dhe keqpërdorime”. Nëse ndaj presidentit zhvillohet impeachmenti, Kushtetuta përcakton se kryetari i gjykatës së Shteteve të Bashkuara do të kryesojë Senatin gjatë gjykimit. Nëse ndaj ndonjë zyrtari është ngritur impeachmenti nga ana e Dhomës së Përfaqësuese dhe është dënuar nga Senati, ai person do të shkarkohet nga posti federative dhe do të parandalohet në marrjen e ndonjë funksioni në administratën federative në të ardhmen. Zyrtari që i nënshtrohet impeachmentit mund të ketë avokat legal për ta përfaqësuar atë. Avokati i tij mund të dëshmojë në çështjen e tij dhe të prezantojë dëshmitë lidhur me mbrojtjen e zyrtarit. Në fund të gjykimit Senati voton në mënyrë të veçantë për çdo pikë të padisë. Për ta akuzuar dhe shkarkuar zyrtarin e akuzuar, për fajësinë e tij duhet të voton 2/3 e numrit të përgjithshëm të senatorëve. Në rast se është ngritur impeachmenti ndaj presidentit, Kryetari i Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara drejton gjykimin e tij në Senat. Senati vendoset si trup për të dëgjuar dëshmitë dhe argumentet kundër tij. Disa pika të impeachmentit mund të ngrihen kundër presidentit, por me dy të tretat

¹⁶ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 86.

¹⁷ Po aty.

në favor të dënimit. Secila pikë akuzuese mund të jetë e mjaftueshme për ta shkarkuar atë nga detyra.¹⁸ Megjithëse procedura e impeachmentit është mjaft e ngjashme me procedurën penale, ato dallojnë mjaft midis tyre. E para, presidenti nuk është e domosdoshme të akuzohet për vepra penale por për sjellje të pahijshme në ushtrimin e detyrës së tij. Konventa Kushtetuese në mënyrë të qartë përjashtoi çdo përpjekje për ngritjen e impeachmentit në baza politike. Presidenti mund, gjithashtu, të jetë përgjegjës për sjelljen e të nënshtruarve të tij. Ai mund të akuzohet për fshehjen e informacioneve lidhur me cenimin e ligjit apo për dështim në shkarkimin e zyrtarëve të tillë nëse provat për keqpërdorimet hynë në përkujdesjen e tij.¹⁹

4.4 Vështrim praktik i rasteve të impeachmentit

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si zyrtarët federal ashtu edhe ata shtetërorë, mund të largohen nga detyra me anë të procesit të impeachmentit.

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara e autorizon Dhomën e Përfaqësuesve që të bëjë akuzimin e zyrtarëve civilë të Qeverisë Kombëtare, përfshirë presidentin dhe zëvendëspresidentin, por jo anëtarët e Kongresit. Ashtu, sikur zyrtarët tjerë federal, edhe Presidenti nuk mund të largohet nga detyra për çështje politike, por vetëm nëse ai akuzohet për tradhti, për ryshfet, për kryerjen e ndonjë akti kriminal, apo për keqpërdorim të detyrës. Deri më tani në Senat janë paraqitur 16 raste të impeachmentit, por me dënim kanë përfunduar vetëm nëntë nga to. Rasti më i ri i impeachmentit në Amerikë është ai i presidentit Donald Trump. Në vitin 2019, Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, e pat ngritur padinë kundër Trump, i cili akuzohej për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ku pretendohet se Trump i kishte kërkuar presidentit të Ukrainës të hetojë ish-zëvendëspresidentin Joe Biden, kundërshtarë i mundshëm në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020. Kërkesa u bë gjatë një telefonatë të zhvilluar më 25 korrik, kur Trump po mbante pezull një ndihmë ushtarake në vlerë 400 milionë për Ukrainën. Transkripti i telefonatës, tregoi se Trump i kërkoi Zelenskit një “favor”. Më pas Trump i kërkoi publikisht Kinës, të hetojë veprimtarinë e djalit të Biden në atë vend. Shtëpia e Bardhë deklaroi publikisht, se nuk do të bashkëpunojë për procedurat e fajësimit, dhe u ka kërkuar zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të qeverisë, të mos dëshmojnë në 3 komitetet e Kongresit që po e hetojnë skandalin Trump-Ukrainë.²⁰ Në dhjetor të vitit 1999, Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga republikanët, e patën ngritur padinë kundër Bill Clinton, i cili akuzohej për dëshmi të rrejshme dhe për bllokim të drejtësisë, në përpjekjet e tij për të fshehur aferën e tij me praktikanten e Shtëpisë së Bardhë, Monika Levinski. Pas dëgjimit të argumenteve për të cilat akuzohej, Senati e shpalli të

¹⁸ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 125.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 76.

pafajshëm. Shefi i parë i ekzekutivit, që është akuzuar nga Dhoma e Përfaqësuesve në Amerikë, ishte Endru Xhonsoni, presidenti i 17-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili sikurse Klintoni, ishte demokrat dhe i cili në fund për mungesë të një vote doli i pafajshëm në Senat. Xhonsoni e mori presidencën e SHBA-ve pas vrasjes së Abraham Lincolnit, për shkak të rolit të tij gjatë Luftës Civile në Amerikë. Ai u akuzua për shkeljen e aktit të mandatit për ndërhyrjet e tij në zgjedhje dhe për përdorimin e panevojshëm të vetos. Për dallim nga Xhonsoni dhe Klintoni, presidenti i 37-të i Shteteve të Bashkuara, Richard Nikson, i shpëtoi procesit të impeachmentit, kur ai u largua nga detyra.²¹

Tetë fazat e procesit të Impeachmentit

1. Rezoluta: Rezoluta për hetimet e rastit të impeachmentit dërgohet në Komisionin për Çështje Juridike të Dhomës së Përfaqësuesve.

2. Vota e komisionit: Pas shqyrtimit të fakteve, Komisioni për Çështje Juridike voton për rezolutën e impeachmentit. Nëse votohet pozitivisht, rasti kalon për votim në Dhomë.

3. Vota në Dhomën e Përfaqësuesve: Nëse Komisioni i rekomandon Dhomës për t'i vazhduar hetimet, Dhoma voton për ose kundër mbajtjes së seancave hetimore nga ana e Komisionit për Çështje Juridike të Dhomës.

4. Seancat: Komisioni për Çështje Juridike i vazhdon seancat hetimore për rastin impeachmentit. Mund të ftohen edhe dëshmitarë për t'i dhënë dëshmitë e tyre.

5. Raporti: Pasi të kenë përfunduar procedurat hetimore, Komisioni për Çështje Juridike e harton raportin, të cilin ia dorëzon Dhomës së Përfaqësuesve.

6. Vota e Dhomës së Përfaqësuesve: Dhoma e Përfaqësuesve voton veç e veç për secilën akuzë. Shumica e votave vetëm për një të akuzë, është e mjaftueshme që rasti të kalojë në Senat.

7. Gjykimi në Senat: Me rastin e gjykimit në Senat, anëtarët e Komisionit për Çështje Juridike të Dhomës i paraqesin akuzat kundër të pandehurit, i cili përfaqësohet po ashtu nga avokatët e tij privatë.

8. Vota e Senatit: Të gjithë senatorët votojnë veç e veç për secilën akuzë. Dy të tretat e votave të Senatit, vetëm për një akuzë, janë të mjaftueshëm për ta dënuar zyrtarin e akuzuar.

5. Sistemi i gjykatave federale

Kongresi i parë i Shteteve të Bashkuara nëpërmjet Aktit Juridik të vitit 1789, e formoi strukturën e gjykatave federale. Në fund janë gjykatat federale

²¹ Po aty.

të distrikteve, së paku një gjykatë e tillë për çdo shtet, e udhëhequr nga gjyqtarët federalë. Pos shteteve, nga një gjykatë e tillë e kanë edhe Porto-Riko dhe Distrikti i Kolumbisë. Në mes qëndrojnë gjykatat federale të apelit, në të cilat mund të apelohej lëndët nga gjykatat federale të distrikteve, kurse në krye qëndron Gjykata Supreme, e cila është gjykata më e lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e vetmja e themeluar nga Kushtetuta. Prej kësaj zanafille ka evoluar struktura e sotme: një gjykatë supreme, 13 gjykata apeli, 94 gjykata distrikti, dhe 2 gjykata me juridiksion të veçantë.

5.1 Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Gjykata Supreme Amerikane, si ushtruese e pushtetit supreme gjyqësor, ka dy cilësi paralele. Ajo trajtohet si Gjykatë Supreme Amerikane dhe si Gjykatë Kushtetuese Amerikane, edhe pse një cilësi e tillë nuk ishte e paraparë me Kushtetutë. Gjykata Supreme Amerikane është themeluar më 2 shkurt 1790. Kompetencat e Gjykatës Supreme Amerikane janë të parapara me nenin 3, paragrafi 1 të Kushtetutës, ku theksohet se: pushteti juridik i SHBA-ve ushtrohet nga një Gjykatë e Lartë dhe nga Gjykata më të ulëta, për formimin e të cilave Kongresi mund të vendosë herë pas here. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit 3 të Kushtetutës parashihet shtrirja e pushtetit juridikë të Gjykatës Supreme të SHBA-ve, duke e cilësuar atë si instancën më të lartë juridike- si Gjykatë e Apelit si për ligjet, ashtu edhe për vendime gjyqësore të gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata Supreme Amerikane do të shërbejë edhe si Gjykatë Fillestare, sidomos kur ka të bëjë me konfliktet, mosmarrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë shtetesh të SHBA-së, ndërmjet shtetasve të shteteve të ndryshme, ndërmjet shtetasve të të njëjtit shtet, që kanë pretendime pronësore, për sipërfaqe në zotërim shteteve të tjera, si dhe ndërmjet një shteti apo shtetasve të tij dhe një shteti të huaj, dhe po ashtu Gjykata Supreme Amerikane gjykon si Gjykatë Fillestare edhe në rastin e gjykimit të ambasadorëve, të dërguarve të tjerë të posaçëm dhe konsujve, si dhe për rastet kur një shtet i veçantë përbën njërën palë në një gjykim. Gjykata Supreme Amerikane deri 1969 kishte gjashtë gjyqtarë tash përbëhet prej 9 gjyqtarëve, njëri prej të cilëve është kryetar i Gjykatës. Gjyqtarët emërohen nga presidenti i SHBA-së dhe miratohen nga Senati Amerikan. Emërimi i tyre është i përvetshëm. Si gjykatë që qëndron në kulmin e piramidës federale, ajo ka prestigj jashtëzakonisht të lartë. Po ashtu Kryetari i Gjykatës llogaritet si personi numër dy në shtet, pas Presidentit të SHBA-ve.²² Kushtetuta nuk thotë gjë për kriteret që duhet të përmbushin gjykatësit. Nuk shtrohet ndonjë kërkesë që gjykatësit të jenë me profesion avokatë, ndonëse, në fakt, të gjithë gjykatësit federativ dhe ata të Gjykatës Supreme kanë qenë anëtarë të avokaturës. Vendimet e Gjykatës Supreme nuk kërkohet të jenë unanime. Në marrjen e tyre kërkohet

²² Hilmi Ismaili, Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë 2009, f. 344-345.

shumica e thjesht, por me kusht që të paktën gjashtë gjykatës të marrin pjesë në gjykim. Kur vendimet janë marrë unanimisht, Gjykata zakonisht publikon si opinionin e shumicës, ashtu edhe atë të pakicës, ose të kundërtën.²³

5.2 Roli i Gjykatës Supreme në zgjidhjen e kontesteve mes legjislativit dhe Ekzekutivit

Gjatë hartimit të kushtetutës është pasur parasysh që gjykatat të jenë të pavarura si nga *legjislatura*, ashtu edhe nga *presidenti*. Kushti, sipas të cilit gjyqtarët federalë zgjedhën me mandate të përjetshëm, u mundëson atyre që të ushtrojnë detyrën në mënyrë të pavarur, pa u frikësuar se mund të ndëshkohen nga Presidenti apo nga Kongresi. Që gjyqësori të fliste pa frikë dhe që të ishte vërtet i pavarur, ai duhej të ekzistonte jashtë kontrollit të degëve të tjera, kështu që Kushtetuta parashikoi një gjykatë të lartë. Ajo e ngarkon Kongresin që sipas nevojës të ngrehë gjykata federale të një niveli më të ulët. Pavarësia e sistemit gjyqësor federal dhe pranimi shoqëror se deklaratimet e tij duhet të ndërtohen, përbëjnë një veçori në sistemin politik amerikan. Në fakt, nuk ka asnjë gjykatë tjetër në botë që t’i afrohet sadopak pushtetit të jashtëzakonshëm që gëzon Gjykata Supreme për të gjykuar mosmarrëveshjet, për të interpretuar Kushtetutën kombëtare dhe për të bërë politikë publike.

Gjatë punimeve të Konventës Kushtetuese në Filadelfi, delegatët debatuan dhe më në fund e kundërshtuan idenë për veton e gjyqësorit ndaj akteve legjislative dhe ekzekutive.

Megjithatë, ata e aprovuan Nenin VI të Kushtetutës, i cili përmban paragrafin e epërsisë kombëtare. Në bazë të këtij paragrafi, për ato raste kur ligjet e një shteti bien në kundërshtim me ligjet kombëtare, fitojnë epërsi ligjet kombëtare. Nga ana tjetër për të hyrë në fuqi një ligj kombëtar, ai duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën. Rasti “Marbëri” kundër Medisonit: Në zgjedhjet presidenciale të vitit 1800, Tomas Xhefersoni, një demokrat-republikan mundi Presidentin Xhon Adams. Në ditët e fundit të administratës së Adamsit, Kongresi që dominohej nga federalistët, krijoi një numër vendesh në gjyqësor, përfshirë 42 gjykatës të paqes për distriktin e Kolumbisë. Senati i konfirmoi këto emërime, Presidenti i firmosi dhe ishte detyrë e sekretarit të Shtetit që t’i vuloste mandatet dhe t’ua jepte të emëruarve. Në vrullin e punëve të minutës së fundit, sekretari që po largohej nga posti, nuk ua dha mandatet katër gjykatësve të paqes, përfshirë Uiliam Marbërin. Xhejms Medisoni, sekretar i ri i Shtetit në administratën e Presidentit Xheferson, refuzoi t’ua jepte mandatet, sepse administrata e re ishte zemëruar me federalistët që ishin përpjekur ta uzurponin gjyqësorin me anëtarë të partisë së tyre. Marbëri ngriti padi në Gjykatën Supreme që kjo ta urdhëronte Medisonin për t’ia dhënë mandatin.

²³ Po aty.

Nëse Gjykata do t'i jepte të drejtë Marbërit, Medisoni prapë mund ta refuzonte dhënien e mandatit dhe Gjykata nuk kishte forcë për ta vënë urdhrin në fuqi. Nëse gjykata nuk do t'i jepte të drejtë Marbërit, ekzistonte rreziku që kompetencat gjyqësore t'u kalonin xhefersonianëve, duke i lejuar kështu që t'ia mohonte Marbërit postin që i takonte me ligj. Kryetari i gjykatës, Xhon Marshall, e zgjodhi këtë dilemë, duke arritur në përfundim se Gjykatës Supreme i mungonte kompetenca për të vepruar në një rast të tillë. Marshalli deklaroi se paragrafi 13 i ligjit për Gjyqësorin, në bazë të të cilit gjykatës i jepej një kompetencë e tillë, ishte jokushtetuese, sepse zgjeronte juridiksionin origjinal të gjykatës jashtë caqeve të juridiksionit të caktuar nga vetë Kushtetuta. Duke gjykuar të mos jepte vendim për këtë çështje, Gjykata Supreme i siguroi vetes pozicionin si arbitrari përfundimtar i ligjit. Në këtë vendim, kryetari i gjykatës mbronte mendimin se e drejta e gjykatës për të përcaktuar kushtetutshmërinë e akteve legjislative është e nevojshme për ta mbështetur Kushtetutën.²⁴

5.3 Raporti midis pushtetit legjislativ dhe gjyqësor

Në sistemin amerikan të ndarjes së pushteteve, me kontrollet dhe balancat e tij, asnjë degë e pushtetit s'mund të përqendrojë pushtet të tepërt. Por çdo degë, dhe organ bartës i saj, është supozuar të ketë pushtet të mjaftueshëm të bëjë atë çka populli kërkon prej tij. Kështu që pushteti është supozuar të jetë i kufizuar por edhe i fuqishëm, i fuqishëm aq sa të mund të mbrojë rendin, stabilitetin, dhe sigurinë e qytetarëve, por jo aq i fuqishëm që të rrezikojë lirinë e tyre. Pushteti gjyqësor, sipas Kushtetutës, është në kompetencë dhe nën autoritetin e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara dhe gjykatave federative më të ulëta kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur rastet e ngritura para tyre në bazë të ligjit më të lartë Kushtetutës, ligjeve federative dhe marrëveshjeve në pajtim me kushtetutën.

Kompetenca gjyqësore e Gjykatës Supreme përfshinë interpretimin e ligjit në marrjen e vendimeve në rastet që paraqiten para Gjykatës. Rastet e supozuara nuk janë objekt i vendosjes para Gjykatës Supreme. Kontrolli gjyqësor i cili nuk parashihet me Kushtetutë, u përvetësua nga Gjykata Supreme dhe u ngrit në një kompetencë të rëndësishme të gjyqësisë federative. Kontrolli gjyqësor është kompetencë për të vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjeve dhe akteve të tjera federative apo të njësive të tjera federale. Në pajtim me këtë koncept, gjyqtarët në gjykata vlerësojnë aktet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv të qeverisë federative dhe të njësive federale kur dyshohet se ato janë në kundërshtim me Kushtetutën. Kontrolli gjyqësor është i mbështetur në tri teza: se Kushtetuta është ligji më i lartë, se aktet në kundërshtim me Kushtetutën janë të pavlefshme dhe anulohen dhe se gjyqtarët

²⁴ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë 2006, f. 119-121.

në gjykatë janë përgjegjës për përcaktimin nëse aktet janë në kundërshtim apo në pajtim me Kushtetutën. Pushteti gjyqësor, përfshirë edhe kompetencën e kontrollit gjyqësor, është një nga tre kompetencat e koordinuara dhe e ndarjes së pushtetit në Shtetet e Bashkuara: në atë legjislativ, ekzekutiv, dhe gjyqësor. Kompetencat e çdo pushteti janë mjaftë të gjëra. Dega ekzekutive në aspektin kushtetues ka liri të madhe në zbatimin e çdo ligji të cilin legjislativi e ka nxjerrë ndërsa, dega e gjyqësorit ka kompetencën e interpretimit ndaj çdo ligji të tillë. Pushteti gjyqësor federative, veç kësaj, ka autoritetin dhe kompetencën e interpretimit të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të nxjerra në bazë të saj; të zbaton ligjet në vendimet lidhur me rastet e ngritura përpara gjykatave dhe eventualisht të shpallë ligjet si jokushtetues nëse ato nuk janë në pajtim me ligjin më të lartë, pra me Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara.²⁵

5.4 Kontrolli Gjyqësor (Judicial Review)

Kontrolli gjyqësor është kompetencë e pushtetit gjyqësor, apo e gjykatave, që të caktojë nëse aktet e degëve tjera të pushtetit janë në përputhje me Kushtetutën. Në çështje e hapur-mbyllur në fillim ishte nëse kompetenca e kontrollit gjyqësor mund të përfshijë edhe të drejtën e anulimit të akteve të degës legjislative apo ekzekutive të pushtetit federative. Në vitin 1788, Alexander Hamilton-i angazhohej për kontrollin gjyqësor si mekanizëm përmes të cilit do të mund të anulohen të gjitha veprimet e pushtetit që janë në kundërshtim me Kushtetutën. Ai mbrojti qëndrimin se kufizimet e kompetencave të legjislativit dhe ekzekutivit për të mbrojtur të drejtat e njeriut “mund të sigurohen në praktikë vetëm nëpërmjet gjyqësorit dhe jo në mënyrë tjetër, detyra e të cilit është të shpallë të gjitha aktet që janë në kundërshtim me Kushtetutën si jokushtetues. Pa kompetencën e kontrollit gjyqësor, të gjitha kufizimet të të drejtave të veçanta apo privilegjeve do të përmbledhen në asgjë. Idetë e kontrollit gjyqësor ishin zbatuar nga John Marshall-i kryetar i Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara, për herë të parë në rastin *Marbury v. Madison* në vitin 1803. Argumenti i Kryetarit të Gjykatës Supreme Marshallit për kontrollin gjyqësor, me të cilin sajoi këtë kompetencë në sistemin e pushtetit federative të kontrollit dhe balancimit, u bë një mekanizëm i fuqishëm i gjykatave federative në mbrojtjen e kushtetutshmërisë së sidomos në rrafshin e të drejtave të njeriut. Kryetari i Gjykatës Marshalli vendosi “parimet, e supozuara që do të jenë esenciale për çdo hartues të kushtetutave, se ligji që nuk është në pajtim me kushtetutën shpallet i pavlefshëm; dhe se gjykatat, që janë si degë tjetër (e pushtetit), janë të kufizuara nëpërmjet këtij mekanizmi.” Nganjëherë, përdorimi i kontrollit gjyqësor nga Gjykata Supreme ka dështuar dhe ka zemëruar si Presidentin ashtu edhe Kongresin. Ndonjëherë gjyqësia federative qëndron pas opinionit publik - për shembull kur gjyqtarët

²⁵ Hilmi Ismaili, Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë, 2009, f. 169-170.

konservativë të Gjykatës Supreme shpallën programet e njohura të New Deal-it si jokushtetuese në vitin 1930. Në vitin 1937, kur Presidenti D.Roosevelt propozoi të “plotësojë” Gjykatën me gjyqtarë të veçantë për të mbrojtur programet e New Deal-it, Kongresi bllokoi planin dhe mbrojti pavarësinë e gjyqësorit. Kongresi mund të miratojë legjislacionin dhe të provojë të përmbush objektivat e Gjykatës ndaj ligjit por në shumë raste ka dështuar. Dy të tretat e Kongresit mund të propozojnë një amandament të ri në Kushtetutë për të hedhur qëndrimet e Gjykatës. Kuptimin e kontrollit gjyqësor James Madison-i e shtroi në mënyrë largpamëse në Kongresin e parë federativ më 8 qershor 1789. Ai parashikonte se “tribunalet e pavarura të gjyqësisë (gjykatat federative) do ta konsiderojnë veten si faktorë i veçantë në mbrojtje të Kushtetutës, të drejtave ... dhe shkeljen e të drejtave të përcaktuara veçanërisht në ligjin e të drejtave”.

5.5 Raporti midis pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor

Gjykata Supreme, deri më sot, i ka trajtuar presidentët dhe Kongresin me plotë respekt. Kjo legjitimoi shumë veprime të presidentit, por në disa raste ishte në kundërshtim me qëndrimet e tyre, sidomos në çështjet që kishin të bënin me sigurinë kombëtare, diplomacinë dhe kompetencat mbi luftën. Gjykata Supreme imunizon presidentin nga proceset civile, kështu që paditja e tyre u bë mjaft e vështirë. Gjykata Supreme nuk e pengoi deri më sot aq shumë presidentin që të ushtrojë më tepër kompetenca dhe pushtet në çështjet e sigurisë kombëtare. Kjo do të vijë në shprehje vetëm kur presidenti, në mënyrë flagrante, do të shkelë Kushtetutën në çështjet e brendshme apo nuk do ta përfillë Gjykatën Supreme kur vendos për kontrollin e Shtëpisë së Bardhë. Madje edhe në rastet e tilla, Gjykata Supreme pret derisa të fitojë përkrahjen e opinionit dhe të Kongresit. Njëkohësisht, gjatë gjithë historisë edhe presidentët kanë treguar respekt të lartë ndaj Gjykatës Supreme. Presidentët, duke përdorur prerogativën kontroverse, ata legjitimojnë veprimin e tyre përmes pohimeve: se kompetencat e tyre për të vepruar dalin nga dispozita të veçanta të Kushtetutës; se Kongresi nuk kishte kundërshtuar dhe kështu kishte pranuar në heshtje apo kishte ndërmarrë veprime të tjera që përkrahin dhe “miratojnë” politikën e tyre; se në raste emergjente apo kur është në pyetje siguria kombëtare, Gjykata Supreme do të tregojë respekt maksimal ndaj presidentit dhe do të njohë kompetencat e tij në vendosjen për çështjet komplekse të sigurisë kombëtare; se kufiri i konfliktit midis presidentit dhe Kongresit është “çështje politike” dhe është jashtë kompetencave të Gjykatës Supreme, etj.

Të shohin se si këto pretendime të ekzekutivit kryqëzohen me kompetencat e gjyqësorit nëpërmjet vështirimit të rasteve të zgjidhura nga Gjykata Supreme gjatë luftës së Vietnamit.

Disa regrutë pohonin se lufta ishte antikushtetuese, ngase nuk u shpall nga Kongresi. Ata deklarorin se ishte antikushtetuese dhe jo legale që presidenti dhe sekretari i mbrojtjes ti dërgojë ata në Vietnam për të luftuar.

Zyrtarët e administratës së Xhonsonit dhe Niksonit pohonin se e drejta për të zhvilluar luftë ishte një e drejtë sovrane e kombit e cila do të ushtrohet nga Kongresi nëpërmjet shpalljes së luftës, apo nga ana e presidentit si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura. Ata, gjithashtu, pohonin se presidenti mund të dërgojë rekrutë çdo kund, prej se kjo ishte kompetencë e tyre si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura dhe nuk ishte ndarë me Kongresin apo ndonjë subjekt që kontrollohet nga Gjykata Supreme. Gjykata Supreme rrallë përdor kontrollin gjyqësor (Judicial Review) për të shfuqizuar aktet e presidentit apo të degës ekzekutive. Në periudhën 1789-1956, Gjykata Supreme shpalli gjashtëmbëdhjetë akte të presidentit si jokushtetues. Në shumicën e rasteve të përfshira, në të cilat aktet e presidentit u deklaruan nga Gjykata Supreme si jokushtetuese, ato kishin të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe politikën e brendshme. Nëpërmjet të këtyre akteve presidenti synonte zgjerimin e kompetencave të tij dhe gjithashtu parashihte një ndërhyrje gjithnjë e më të vogël të pushtetit gjyqësor në çështjet që kishin të bënin me pushtetin ekzekutiv. Refuzimin që ia bëri Gjykata Supreme deklarimin e këtillë të akteve të presidentit e arsyetonte me faktin se presidenti nuk ishte në gjendje të përcaktojë integritetin e sistemit kushtetues të vendit. Gjykata Supreme, disa herë, ushtroi kontroll ndaj presidentit në mënyrë të tërthortë. Presidenti Nikson argumentonte se ai kishte kompetencën kushtetuese të refuzojë shpenzimin e fondeve të caktuara nga Kongresi dhe kështu i kishte propozuar legjislativit që të nxjerrë ligje të caktuara për stabilizimin ekonomik. Gjykata Supreme hodhi poshtë rastin, ngase Kongresi kishte të drejtën që në mënyrë të drejtpërdrejtë të kontrollojë se si do të shpenzohen parat. Si përfundim, Gjykata Supreme vazhdimisht i porosiste zyrtarët ekzekutiv që të pajtohen me ligjin. Nganjëherë Gjykata Supreme kundërshton politikën e presidentit. Në rastin *Ex Parte Milligan* Gjykata Supreme ia tërhoqi vërejtjen Presidentit Linkoln për përdorimin pa vend të gjykatave ushtarake në gjykimin e qytetarëve në shtetet në të cilat gjykatat e rregullta funksiononin gjatë Luftës Qytetare. Por ky rast nuk paraqiste një konfrontim të madh midis pushtetit civil gjyqësor dhe pushtetit ushtarak: lufta tashmë kishte mbaruar dhe Linkoln po ashtu kishte vdekur. Realiteti është më i ndërlikuar se doktrinat që e përmendëm, ngase Kushtetuta dhe ligjet janë duke u interpretuar çdo ditë nga të gjitha organet e pushtetit. Kur gjykatat ushtrojnë kontrollin gjyqësor, ato nuk janë duke ushtruar një funksion ekskluziv, por një funksion që është i ndarë gjatë gjithë qeverisjes. Kontrolli gjyqësor është i përcjellë nga kontrolli politik, në të cilin opinion, partitë dhe politikanët për më tepër pranojnë vendimin gjyqësor apo krijojnë kushtet në të cilat mund të modifikohen, shkelen, apo hidhen poshtë vendimet e Gjykatës. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme mund të vendosin edhe për atë se sa t'ju japin hapësirë apo liri veprimi dy degëve tjera të pushtetit në udhëheqjen e politikës kombëtare të vendit, duke treguar edhe respektin ndaj tyre në udhëheqjen e politikës kombëtare nëpërmjet interpretimit të Kushtetutës dhe ligjeve që ushtrohet nëpërmjet kontrollit

gjyqësor apo aktivizmit gjyqësor “Në demokracinë kushtetuese, përmbajtja morale ligjit duhet t’i jepet nëpërmjet moralitetit të miratuesit apo legjislatorit, e asnjëherë nëpërmjet moralitetit të gjykatësit,” pohoi Robert Bork, një gjyqtarë në Gjykatën e Apelit. Në Gjykatën Supreme veprojnë, po ashtu, disa grupe të veçanta që nuk janë pjesë e saj, e që vazhdimisht përpiqen të ndikojnë në vendimin përfundimtar që e jep kjo gjykatë. Këto grupe quhen *amicus curiae brief*²⁶

Conclusions

After the independence of the 13 English colonies in North America and their union in the American Confederation, several events that occurred during the decade of the functioning of that Confederation, laid the need for closer ties in a common federal state and for the state regulation of such a state. American nationalists emphasized that the government under the Articles of Confederation was powerless, labeling the Confederacy as a thirteen-headed puppet state. The state arrangement based on the Articles of Confederation did not provide the effective government required by this form of union. It lacked an executive branch and a national court system. It could not regulate trade between the states, nor tax the states or their citizens, and, above all, as such, could not protect the security of the country. It was only an assembly of representatives of the 13 independent states, characteristic of all confederations. The Constitution of the United States has always presented an inexhaustible source of the continuous development of the American political system and social system in general.

The Constitution and its timely interpretation by the Supreme Court have, over the decades, enabled high stability and durability of the institutions of political power. Thanks to its adaptive capabilities, high elasticity and flexibility, this Constitution survived the industrial revolution, the civil war of 1861-1865, the concerns that provoked periodic depressions, the economic crisis of 1929-1933 and the disorders that provoked the two world wars. However, what was emphasized does not give us the right to conclude that the Constitution of the United States is omnipotent and has extraterrestrial legal-political immunity. The analyses carried out show that the principle of separation of powers, which implies a very pronounced autonomy of the three branches of power that, according to the Constitution, were supposed to limit each other and maintain a balance, has undergone certain deformations thanks to the strengthening of the role of the state. The apparatus of executive power, in terms of the power it has and its size, exceeds the constitutional framework.

²⁶ Zenun Halili, *Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*, Prishtinë, 2006; f. 183-185.

The office of President of the United States is one of the most powerful in the world. The President, according to the Constitution, must “take care that the laws be faithfully executed.” To exercise this function, he heads the executive-administrative branch of the federation - a vast body of nearly three million people, including an effective military personnel of another one million.

One of the biggest problems that a new president faces at the beginning of his term is the inherited bureaucratic structure, difficult to manage and clumsy to take a different direction. The post-election euphoria of the “honeymoon” quickly ends and the new president discovers that Congress has become less cooperative, while the media has become more critical. Finally, the president is forced to build temporary alliances between different, often antagonistic, economic, ethnic and ideological interests, in which case compromises must be made with Congress. Despite these limitations, every president achieves at least some of his goals in relation to the legislature because, through his veto power, he prevents the enactment of other laws that he believes are not in the best interests of the country.

With regard to the judicial power as carried by the Supreme Court, we have first referred to the main tension between the Court as a political institution that makes national policy and the basic principles of representative government. Judges generally decide cases in accordance with their own views from practice. This contradicts the idea that the Supreme Court simply interprets the Constitution through developed methods of legal reasoning.

The idea of the Fathers of the Constitution that there should be a separation of powers into three branches, where each branch would exercise such powers that the other branches would not be able to exercise, had its roots in the English experience. The system of checks and balances requires that Congress and the President work together if they want to achieve anything. This system also causes friction between the branches of power, and sometimes poses a danger, because it appears incompetent in moments when the nation is in crisis. Each of the branches of power, whether legislative, executive or judicial, throughout the entire period of the existence of the American state, has tried to expand its powers by “reinterpreting” these constitutional formulations.

The president’s most powerful mechanism for controlling Congress is his veto. The veto is a presidential mechanism that he uses to reject laws passed by Congress. The veto is often a threat that the president uses to influence the legislature. Since a two-thirds majority of both houses of Congress is required to override a veto, only about 7 percent of the president’s vetoes have been overridden to date. Another threat to constitutionalism is the president’s increasing use of executive power in directing public policy. Despite the constitutional limit on war and treaty-making powers between Congress and the President, many presidents throughout the twentieth century have used

their powers to command the nation's armed forces and conduct foreign policy to expand presidential powers. The presidents' strategy for expanding their powers is quite clear: any claim to power will be justified by the assertion that Congress has clearly and absolutely cooperated in the exercise of its functions.

From all that has been discussed, we can conclude that the separation of powers is a very characteristic attribute of the American national government. However, we must also note that the Constitution does not separate powers to the extent of creating "the power of separate institutions with the separation of powers". Its effect is modernization, and for this reason, such a system is often called a system of checks and balances. This system reduces the risk that one branch will be able to forcibly take all the power or stay too far away politically from the other branches. This determination, according to this system, was a very important factor that influenced the survival of the American constitution.

The election of the president of the state is a chapter in itself. The existing electoral system for the post of president and vice president has many shortcomings. First, the elections for president are not direct but indirect. Second, the "unit rule" principle, according to which all the votes of the electors of a state belong to the party that has won the majority of the votes in the state in question. Third, the electoral system itself enables the candidate who has won the fewest votes, but who has secured the number of electoral votes, to be elected president in many cases. Fourth, the electoral system forces the presidential candidate to take into account the special interests of interest groups if he wants to secure wider support.

As for the federal units, or individual states, it should be emphasized that they have a developmental autonomy vis-à-vis the federal bodies. The federation, through its funds and certain facilities, helps the less developed states. Local government is also not unified throughout the territory of the United States. However, despite its complexity, it is quite functional. The organization of local government is not within the competence of the federation, but within the competence of the individual states.

Finally, it should be added that American federalism, and the political organization within it, were not constituted and do not function according to any ethnic key. In the United States, the regulation of multi-ethnicity, multiculturalism, multi-racialism, and multi-confessionalism is regulated according to American conditions and circumstances that differ from other countries facing a similar population structure.

Recensentë:

Prof. dr. Jeton Shasivari

Prof. dr. Blerton Sinani

Referencat:

- Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2006;
- Hilmi Ismaili, Fatmir Sejdiu, Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë, 2009;
- Fisnik Korenica, Dren Doli, Kushtetuta Amerikane dhe rruga juridike deri te ajo, Prishtinë, 2005;
- Llambro Filo, Juliana Marko, Historisë e Kohës Moderne, Tiranë, 2006;
- Vështrim mbi Sistemin Amerikan të Qeverisjes, Zyra e programeve ndërkombëtare të informacionit, Departamenti i shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Sq.m.wikipedia.org;